



VENDIM

Nr. 41 Datë 15.04.2011

PËR

FILLIMIN E PROCEDURAVE TE SHQYRTIMIT TE APLIKIMIT TE SHOQERISE ENERGJI ASHTA SH.P.K PER KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES HEC ASHTA SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, germa “l”, dhe nenit 9 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa “d”, dhe 3 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 21 datë 18.03.2009, dhe nenit 8 të Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.9, datë 21.02.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 15.04.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energji Ashta” sh.p.k për kualifikimin e impiantit prodhues HEC “Ashta”, si burim i rinovueshëm energjie, dhe konstatoi rregullshmerinë e paraqitjes së aplikimit të shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k,

VENDOSI :

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Energji Ashta sh.p.k, për kualifikimin e impiantit prodhues Hec “Ashta”, si burim i rinovueshëm energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 41 Datë 15.04.2011

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE TE SHQYRTIMIT TE APLIKIMIT TE
SHOQERISE ENERGJI ASHTA SH.P.K PER KUALIFIKIMIN E
IMPIANTIT PRODHUES HEC ASHTA SI BURIM I RINOVUESHËM
ENERGJIE**

Anetaret e Bordit

	Pro	Kundër
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkelqim Bozgo	_____	_____